

**STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Albanimpex” SH.P.K.**

Neni 1
Formimi

Sot me datë 07.08.2023, Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Albanimpex” SH.P.K. themelohet në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”. Kjo shoqëri krijohet sipas marrëveshjes së Ortakëve dhe Aktit të Themelimit të hartuar prej tyre.
Ortakët themelues;

1. Ali Kızılarmut, i datëlindjes 10.10.1968, lindur në Koyulhisar-Turqi dhe banues në Tiranc,

Neni 2
Emërtimi Selia e Shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë në bazë të këtij Statuti dhe do të ketë emërtimin “Albanimpex” SH.P.K., do të ushtrojë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë në bazë të Regjistrimit në Institucionet përkatëse, si dhe jashtë saj në bazë të modaliteteve ligjore që kërkohen nga shteti ku do të ushtrojë veprimtarinë.

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “Albanimpex” SH.P.K. është në adresën: Rruga Dytësore Tirane-Vore Km.10, Pasuria 175-ND, Kati-1 Berxull, Tirane.

Neni 3
Kohëzgjatja


Kohëzgjatja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Albanimpex” SH.P.K. është i pacaktuar. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e aktivitetit mund të shkurtohet, të ndërpitet tërësisht ose menjëherë.

Neni 4

Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Albanimpex” SH.P.K. për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e saj. Ortakët e kësaj shoqërie nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasuritë e tyre që nuk janë futur në kapitalin e kësaj shoqërie. Pjesëmarrja në këtë shoqëri nuk pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

Neni 5
Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “Albanimpex” SH.P.K. do të jetë:



1. Të importoje dhe eksportoje leter dhe prodhimet pyjore
2. Të tregtoje me shumicë dhe pakicë leter dhe prodhime pyjore
3. Tregimi me shumicë i të gjithë llojeve të metaleve
4. Tregimi me pakicë i të gjithë llojeve të metaleve
5. Importimi dhe eksportimi i të gjitha llojeve të metaleve
6. Të ndërtojë ndërtesa banimi, ura, vepra arti dhe çdo lloj pune që lidhet me ndërtimin
7. Të bëjë montimin e ndërtesave parafabrikate
8. Të ndërtojë Hotele dhe Resorte Turistike
9. Të hapë dhe menaxhojë Hotele, Resorte Turistike, Bar Kafe etj
10. Të hapë dhe menaxhojë agjensi turistike
11. Të operojë në fushën e turizmit
12. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e pajisjeve elektrike dhe materialeve elektrike dhe materialeve te ndertimit.
13. Të importojë, eksportojë, prodhojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakice mobilje
14. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumice dhe pakicë të gjithë llojet e tekstileve, veshje, veshmbathje, copa etj.
15. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e pajisjeve elektronike.
16. Të kryejë transport brenda dhe jashtë vendit të mallrave të veta dhe të të tretëve me mjetet e veta ose të kontraktuara nga të tretë për përbushjen e këtij qëllimi.
17. Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaja. Të përfaqësojë shoqëri të huaja.
18. Të kryejë shitblerjen me shumicë dhe pakicë të të gjitha materialeve dhe shërbimeve të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 6

Aktivitete mbështetëse

Shoqëria mund të hapë llogari në të gjitha bankat dhe institucionet financiare, si në Republikën e Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj për të kryer dhe marrë pagesa, mund të mbyllë llogaritë, mund të marrë karta ATM, mund të anullojë kartat e marra, mund të marrë karta krediti, mund të anullojë kartat e marra të kreditit, mund të marrë makinë POS, mund të mbyllë makinat POS të marra, mund të marrë POS virtuale, mund të mbyllë POS-et virtuale. Për këto veprime janë në fuqi kufizimet në të drejtat e administratorit. Shoqëria mund të përdorë çdo lloj llogarie në PayPal, mund të mbyllë çdo lloj llogarie në PayPal. Mund të marrë pagesa nëpërmjet PayPal dhe mund të bëjë pagesa nëpërmjet PayPal.

Neni 7

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë “Albanimpex” SH.P.K. është 10.000.000 (Dhjete milion) Lekë, i ndarë në 1 kuote si vijon:

1. **Ali Kızılarmut** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10.000.000 (Dhjete milion) Lekë që përbën **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Neni 8

Situatat kur kërkohet vendim nga Asambleja e Ortakëve me numër kuotash të cilat të marra së bashku përbëjnë 100% të vlerës së kapitalit

Për kryerjen e akteve të mëposhtme nevojitet dhe është i mjaftueshëm një vendim me numër kuotash të cilat së bashku përbëjnë të paktën 100% të vlerës së kapitalit të shoqërisë;

1. Blerje dhe Shitje pasuri të paluajtëshme
2. Ushtrim aktiviteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
3. Hapja dhe mbyllja e degëve
4. Ndryshime në statutin e shoqërisë
5. Vendimi për shtimin e kapitalit të Shoqërisë
6. Emërimin, zëvendësimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar

Neni 9

Administratori


- Administrator i shoqërisë do të jetë **Z.Ali Kızılarmut**. Shoqëria do të administrohet nga **Z.Ali Kızılarmut** si administrator i saj, i cili do të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënet me të tretë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- Administratori kanë të drejtë të përfaqësojë shoqërinë sipas të drejtave dhe kufizimeve të përcaktuara në statut.
- Emri i shoqërisë, administratorit si dhe vula e shoqërisë duhet të figurojnë në të gjitha shkresat zyrtare të shoqërisë si dhe në dokumentat që kanë të bëjnë me përbushjen e objektit, apo që i shërbejnë ushtrimit të aktivitetit të saj.
- Administratori mban përgjegjësi për shkelje të ligjit, statutit, rregullores së brendëshme para asamblesë, të tretëve dhe instancave ligjore.
- Shoqëria nuk merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet apo veprime juridike të administratorit kur këto nuk i janë përbajtur objektit të veprimitarës së shoqërisë ose nuk janë në qëllim të përbushjes së objektit.
- Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga 1 administrator ose me shume.

Neni 10

Të Drejtat dhe Kufizimet e Administratorëve

a) Administratori ka këto të drejta:

- Të mbikqyrë dhe të kontrollojë të gjithë veprimtarinë e shoqërisë.
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënet e saj me të tretët, në administratën publike e në organet gjyqësore.
- Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik.
- Të paraqesë për miratim Ortakëve të shoqërisë strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës në Republikën e Shqipërisë.



- Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuar nga Asambleja e Ortakëve.
- Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë.
- Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizmin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga prej tij.
- Ka të drejtë të hapë dhe të mbyllë llogari bankare si dhe të kryejë çdo lloj veprimi dhe transferte në të gjitha bankat e nivelit të dytë.
- Administratori ka të drejtë dhe detyrim të përgatisë Bilancin Vjetor, Bilancin e Konsoliduar dhe Raportin e Ecurisë së veprimitarisë dhe t'i paraqesë ato për miratim para Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- Administratori Vepron me qëllim të mirë
- Administratorët kanë të drejtë të thërrasin Asamblenë e Ortakëve secili veç e vec

Neni 11

Të Drejtat dhe Detyrat e Ortakëve

- Veprojnë me qëllim të mirë
- Të paraqesin pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit
- Të informohen mbi përbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara dhe raportin e Ekspertit Kontabël ose Kontabilistik të Miratuar.
- Të përfitojnë nga fitimi i Shoqërisë
- Ortakët kanë të drejtë secili veç e veç të marrin informacion mbi gjendjen e kredive të shoqërisë nga Banka e Shqipërisë.
- Ortakët kanë të drejtë secili veç e veç të marrin informacion mbi gjendjen e shoqërisë nga Kontabilisti.
- Në rastet kur ortakët duan të shesin kuotat e tyre duhet të marrin miratimin e ortakëve dhe është i mjaftueshëm një vendim me kuota vlera e të cilave përbën 100% të vlerës së kapitalit të Shoqërisë.
- Mund të emërojnë dhe shkarkojnë Administratorin me shumicë të thjeshtë 50% + 1 votë.
- Mund të emërojnë dhe shkarkojnë Ekspert Kontabël të Autorizuar dhe Likuidator për Shoqërinë me vendim unanim me kuota vlera e të cilave përbën 100% të vlerës së kapitalit të Shoqërisë.
- Asambleja e Ortakëve mund të thirret nga ortakët kuotat e të cilëve përbëjnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë.
- Kanë të drejtë të përfaqësohen nga përfaqësues me prokurë duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 12

- Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme mer vendim për:
 - 1- Vlerësimin e veprimitarisë së tij
 - 2- Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij
 - 3- Ngritjen e një padie ndaj tij nga ana e shoqërisë
 - 4- Dhënien ose jo të përfitimeve të reja
- Kur Ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar edhe i autorizuari, njësoj si ortaku, do të vlerësohet përmundësinë e të qëndrit në konflikt interesit.



- Nëse nuk merret një vendim i ndryshëm me numër kuotash të cilat përbëjnë 100% të vlerës së kapitalit të shoqërisë, fitimi i shoqërisë do të ndahet në masën 50% si dividendë dhe 50% do të shkojë për rritjen e kapitali të shoqërisë.

Neni 13 Viti Fiskal

- Viti fiskal fillon në datën 1 Janar dhe përfundon në datën 31 Dhjetor, perjashtim bën viti i parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Raporti vjetor finançiar i paraqitet ortakëve për aprovim para 31 marsit të vitit pasardhës.
- Ortakët e shoqërisë vendosin me vendim unanim për destinimin e fitimit apo humbjes së krijuar gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 14 Marrëdhëni e Punës

Marrëdhëni e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 15 Dispozita të përgjithshme

Përsa nuk është shprehur në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, si dhe çdo dispozitë e Legjislacionit Shqiptar që gjen vend në këto marrëdhënie juridike e tregtare.

Neni 16

- Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë.
- Ky akt formulohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 1(një) kopje.
- Ortakët e shoqërisë i jepin të drejtën **Z.Armand Shkurta**, të paraqitet pranë QKB-së dhe çdo institucioni tjeter për regjistrimin e shoqërisë **“Albanimpex” SH.P.K.**

ORTAKU I SHOQERISE

Ali KIZILARMUT

Ali KIZILARMUT